



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:231268

Datë: 10.09.2024

Numri i dokumentit: 06143668

C.nr.195/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), të cilën e përfaqëson e autorizuar B.G , kundër të paditurit Sh.Z, , me objekt kontesti rimbursim dëmi, më datë 10.09.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I.** NDËRPRITET procedura në këtë çështje juridike kontestimore sipas padisë C.nr.195/2019, të datës 03.05.2019, për shkak të vdekjes së të paditurit Sh.Z.
- II.** Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të ndjerit-paditurit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës paditëse.

A r s y e t i m

Paditësja BKS ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datën 03.05.2019, kundër të paditurit Sh.Z, lidhur me çështjen me objekt kontesti rimbursim dëmi.

Gjykata në seancen e mbajtur më datën 18.07.2024, në të cilën seance ka qenë prezente përfaqësuesja e paditëses ndërsa ka munguar i padituri Sh.Z , për të cilin nga fletëkthesa e datës 10.07.2024, është konstatuar se “Pala ka dy vite që ka ndërruar jetë”.

Gjykata më datë 22.07.2024, më qëllim të vërtetimit të faktit të vdekjes së të paditurit , ka kërkuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Komunës së Vushtrrisë, certifikatën e vdekjes së të paditurit Sh.Z.

Zyra e Gjendjes Civile Komuna e Vushtrrisë, me datë 23.07.2024, në mënyrë elektronike e ka dorëzuar certifikatën e vdekjes për të paditurin Sh.Z, me nr. serik: V10696784, përmes së cilës vërtetohet se i padituri, ka vdekur me datë 03.03.2022 në Vushtri.

Prandaj gjykata konform nenit 277 pika (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), sipas të cilës thuhet: “*Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale*”, vendosi si në dispozitivin I të këtij aktvendimi sepse është vërtetuar se i padituri ka vdekur, kurse si në dispozitivin II, të tij vendosi duke u bazuar në nenin 280 par 1, të LPK-së.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:231268, C.nr.195/2019, me datë 10.09.2024**

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas pranimit të së njëjtit, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.